



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:077695

Datë: 20.06.2019

Numri i dokumentit: 00369956

P.nr. 202/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN/ Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Fatmire Sermaxhaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit Xh. S. me vendbanim në fshatin Zhegër K. Gjilan, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 paragrafi 1 KPRK-s, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.304/2019 të datës 28.02.2019, të cilën e përfaqëson prokurori Shefik Memeti pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar më datë 18.06.2019 mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri Xh. S., i biri i dhe nënës e lindur, i lindur më, në fshatin Zhegër ku edhe jeton, me numër, din shkrim dhe lexim, ka të kryer klasën e parë të shkollës fillore, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, i martuar-baba i 4 fëmijëve, shqiptar, shtetas i R. të Kosovës, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 09.10.2018, në kohë të pa caktuar në shtëpinë e tij në fshatin Zhegër Komuna e Gjilanit, i pandehuri Xh. S., si konsumator i energjisë elektrike, me qëllim që vetit ti sjell përfitim të kundërligjshëm pasuror ka përfituar në mënyrë të kundërligjshme nga shpenzimet e energjisë elektrike të KEDS-it-Distribuimi në Gjilan i njëjti nga punëtorët e autorizuar të KEDS është shkyqur nga distanca prej rrjetit elektrik, më vonë gjatë kontrollit të kryer te i pandehuri i lartë shënuar është vërtetuar se i njëjti ka bërë një lidhje direkte në rrjetin elektrik, me këtë rast nga kjo lidhje ka furnizuar me energji elektrike paisje të amvisnisë në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta të kundërligjshme të dëmtuarën KEDS-in-Distribuimi në Gjilan i ka shkaktuar dëm material në shumë prej rreth 65 €.

Me çka ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 paragrafi 1 KPRK-s. Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 46, 73, 74 dhe 75 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarit i shqipton,

DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarit Xh. S., i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 100 (njëqind) euro, të cilin denim do ta paguaj në afat prej 90 ditë pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri refuzon të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë atëherë dënimi me gjobë me pajtim me të pandehurin zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme ashtu që 8 (tetë) orë të punës do të barazohen me 20.00 € (njëzet euro) ndërsa nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimin me gjobë në punë në dobi të përgjithshme atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20.00 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest juridiko civil. Obligohet i pandehuri që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20.00 € (njëzetë euro) në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

1. Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 28.02.2019, ka ngritur aktakuzën PP.II.Nr.304/2019, kundër të akuzuarit Xh. S. me vendbanim në fshatin Zhegër K. Gjiilan, për shkak të veprës penale Lidhja e paautorizuar në shërbime, nga neni 321 të KPRK-s. Në shqyrtimin fillestar dhe publik të datës 18.06.2019 prezent ishin prokurori i shtetit Shefik Memeti dhe i pandehuri Xh. S., në të cilën seancë prokurori i shtetit pas leximit të aktakuzës ka bërë rikualifikimin e veprës penale nga Lidhja e paautorizuar në shërbime, nga neni 321 të KPRK-s, në veprën penale Vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 paragrafi 1 KPRK-s, i pandehuri pas leximit të aktakuzë dhe rikualifikimit të veprës penale nga ana e Prokurorit deklaroi se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale.

2. Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit Xh. S., për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar as i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranoj fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj veprë, ekziston fakti se i pandehuri Xh. S. ka kryer veprën penale, Vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 paragrafi 1 KPRK-s, në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve lidhur me dënimin, ka shpallur fajtor të akuzuarin Xh. S. për shkak të veprës penale, Vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 paragrafi 1 KPRK-s, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën është dhe penalisht përgjegjës.

Në bazë të nenin 314 të KPRK-së Vjedhja e shërbimeve konsiderohet:

Kushdo që me anë të lajthimit, largimit ose mënyrave tjera siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK-s, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe të njëjtit ti shqiptohet dënim me gjobë, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, ashtu që për të akuzuarin Xh. S. si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, dhe se i njëjti është penduar, i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti dëmin e shkaktuar të dëmtuarës dhe se kjo veprë penale kryhet vetëm me dashje.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit Xh. S., duke marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-s, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest juridiko civil.

8. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurve, gjykata, duke u bazuar nënin 453 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar shpenzimet e procedurës penale, dhe paushallin gjyqësor, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 202/2019, Me datë 18.06.2019

Sekretarja Juridike
Fatmire Sermahaj d.v

Gjyqtari
Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE; Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të përgjithshëm në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.